

L I G J
Nr.9173, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR NË PROJEKTIN “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE ADF-III-SHQIPËRIA VERIORE DHE LINDORE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar në projektin “Fondi i investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4132, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR
(Fondi i Investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare shqiptaro-gjermane të datës 5 dhjetor 2001,
u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, shumat e mëposhtme:

1) një hua me vleftë prej gjithsej deri 2 301 000 euro (dy milionë e treqind e një mijë euro) për projektin "Fondi i investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore";

2) një shumë financimi me vleftë prej gjithsej deri 256 000 euro (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë

mijë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1.

U konstatua se projekti në tërësi vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera. Në qoftë se projektet e përmendura në paragrafin 1 do të zëvendësohen me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose një fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose një masë e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 pika 1, ose shuma të tjera financimi për masa të mëtejshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 pika 2, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masat përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikat 1 dhe 2, në rast se nuk përdoren për masa të tilla, do të kthehen në hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, të cilët i nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 do të zhvleftësohet në rast se kontratat përkatëse për huanë dhe financimin nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumat në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2009.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau, për pretendimet e mundshme lidhur me kthimin e shumave, pretendime të cilat mund të ngrihen në bazë të kontratave të financimit që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e ligjit në fuqi. Përcaktues është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë në datën 22.9.2003 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.